

URDHËR
Nr. 144, datë 30.3.2021

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdo lloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Shkodrës, nga data 1.4.2021 deri më 30.6.2021, me përjashtim të ngjalës, e cila lejohet të peshkohet vetëm me grepa dhe vetëm për periudhën 1.4.2021 deri 30.4.2021, siç është parashikuar në Planin e Menaxhimit të Ngjalës.

2. Për periudhën 1.5.2021–30.6.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jenë vendet e përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), “Liqeni i Shkodrës”.

4. Për periudhën një mujore të lejimit të peshkimit të ngjalës, nga ana e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit Shkodër, të ketë monitorim të sasive ditore të peshkuara. Sasia e ngjalës së zënë grumbullohet dhe tregtohet te Qendra e Parë e Ankandit Shirokë.

5. Peshku (speciet e familjes Krap) i bllokuar nga Roja e Peshkimit (OMP-Liqeni Shkodër) dhe nga kontrollet e përbashkëta të Rojes së Peshkimit (OMP-Liqeni Shkodër), Inspektoratit të Peshkimit, Policisë Kufitare apo strukturave të tjera që ngarkon ky urdhër, grumbullohet dhe ruhet në Qendrën e Ankandit të Parë Shirokë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri të hartohet një Plan i Përbashkët Operativ Veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-në e këtij liqeni.

7. OMP-Liqeni i Shkodrës të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit (gjuhçë) kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

8. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në varësi të së cilës është Sektori i Kontrollit të Peshkimit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në qarkun e Shkodrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi